



Datë: 20.04.2026

A.nr.262/2026

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**– Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtare, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, në cilësinë e procesmbajtëse, ka shqyrtuar ankesën A.nr.262/2026, të datës 06.03.2026, të parashtruar nga ankuesja L.J, kundër organit të punësimit Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike ,më objekt ankimor “*kundërshtim i vlerësimit të rezultateve në punë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 dhe 1.4 , të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 20.04.2026, mori këtë:

## V E N D I M

- I. Aprovohet** ankesa A.nr.262/2026, e datës 06.03.2026, e parashtruar nga ankuesja L.J.
- II. Detyrohet** Udhëheqësi i Divizionit për Buxhet dhe Financa në MPJD që të bëjë vlerësimin e rezultateve në punë të ankueses sipas dispozitave ligjore në fuqi.
- III. Obligohet** sekretari i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i NJMBNJ në MPDJ që të kujdesen për zbatimin e këtij vendimi sipas pikës **II** të dispozitivit brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e pranimit të tij.
- IV.** Këshilli duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarrura lidhur me zbatimin e këtij vendimi.

## A r s y e t i m

Nëpunësja civile L.J (*tutje referuar ankuesi*), më datë 06.03.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me mos vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2025, nga ana e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë me pretendimin se është obligim ligjor që të bëhet vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2025 për ankuesen.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 25.03.2026, i ka përcjellë shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje administroi këto prova:** Ankesën me numër protokolli 1178/2026 të datës 06.03.2026 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Kopjen e ID-së së ankueses; Përgjigjen në ankesë të datës 25.03.2026, emailin e F.Z të datës 16.03.2026; Planin individual vjetor për vitin 2025; Akt emërimit të datës nr.914 të ankueses.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankesa është e bazuar, **sepse:**

Nga provat e lëndës, Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesja sipas Akt Emërimit me Nr. port:5605 të datës 23.10.2024 është e punësuar në pozitën *Zyrtare e Lartë e Shpenzimeve dhe Financave/Divizioni për Buxhet dhe Financa*, në MPJD.

Ankuesja ka parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankesën me pretendimet sikur se janë shënuar në hyrje të këtij arsyetimi.

Kolegji i Këshillit në kuptim të pranushemërisë së ankesës iu referua dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrarët Publikë që rregullojnë vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë, me theks të veçantë nën 52 me të cilin është përcaktuar se: 1. *Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i vazhdueshëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuara, vlerësimin e aftësisë profesionale, metodologjike, personale dhe sociale të nëpunës/it civil në realizimin e objektivave dhe përmbushjen e përgjithshme të përgjegjësisë të njësisë.* 2. *Periudha e vlerësimit zgjat një (1) vit, nga 1 janari deri me 31 dhjetor. Procedura e dhënies së vlerësimit përfundon deri më 28 shkurt të vitit pasues.* 3. *Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në: 3.1. realizimin e objektivave të paracaktuara në planin vjetor individual, përmbushjen e detyrave të punës në përputhje me përshkrimin përkatës të punës, objektivat e njësisë dhe institucionit, si dhe kryerjen e detyrave të atypëratisme që nuk janë paracaktuar paraprakisht apo nuk kanë mundur të paracaktohen; 3.2. aftësitë profesionale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës, si dhe sjelljen profesionale; 3.3. aftësitë metodologjike, personale dhe sociale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës.* 4. *Përcaktimi i objektivave individuale të nëpunës/it civil bëhet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë në bashkëpunim me nëpunësen/in dhe përfaqësuesen/in e njësisë së burimeve njerëzore, me shkrim, në muajin janar të çdo viti, së bashku me planin individual të punës për arritjen e këtyre objektivave.* 5. *Plani individual i punës i përcaktuar në paragrafin 4. të këtij neni, mund të rishikohet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore, në bashkëpunim me nëpunësen/in civil.* 6. *Procedura e vlerësimit të rezultateve në punë përfshin dy (2) faza kryesore: 6.1. mbikëqyrjen e vazhdueshme të rezultateve të punës nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë; 6.2. vlerësimin vjetor të rezultateve të punës nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore.* 7. *Performanca e nëpunës/it civil të kategorisë profesionale dhe kategorisë së specialistes/it vlerësohet nga mbikëqyrësja/ie saj/tij i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore....* 9. *Përfundimisht, në rastin e ndërrimit të mbikëqyrës/it përpara përfundimit të vlerësimit vjetor, secila/i mbikëqyrëse/ës vlerëson nëpunësen/in vetëm për periudhën përkatëse.* 10. *Përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore, merr pjesë, mbështet dhe vëzhgon çdo proces të vlerësimit.* 11. *Mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë gjatë procesit të vlerësimit është e/i obliguar të vlerësojë nëpunësen/in në mënyrë objektive dhe të argumentojë vlerësimin.* 12. *Në fund të periudhës së vlerësimit, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore zhvillojnë takim me nëpunësen/in për*

*vlerësimin e rezultateve të punës. Pas takimit, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë aprovon formularin e vlerësimit që e nënshkruajnë të gjitha palët.*

Prandaj mos përmbushja e këtij obligimi nga ana e organit kompetent për vlerësim është veprim në kundërshtim me dispozitat e lartshënuara, sepse vlerësimi i vartësve është obligim ligjor dhe jo diskrecional, veprimi i Ushtruesit të detyrës së Udhëheqësit të Divizionit për Buxhet dhe Financa bie ndesh edhe me nenin 56 të Ligjit Nr.08./L-197 *Shkeljet e detyrave dhe përgjegjësive* respektivisht paragrafi 4. Shkelje të rënda konsiderohen nën paragrafi 4.1. *mospërmbushja e detyrave të punës*;, si dhe nën paragrafi 4.20. *shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi*, sepse obligimi për vlerësimin e vartësve është detyrim i përcaktuar në nenin 52 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Andaj, në kuptim të kuadrit ligjor si me lart dhe duke qenë së ankuesja për vitin 2025 nuk është vlerësuar nga mbikëqyrësi, Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e ankueses është e bazuar, sepse, siç përcaktohet me dispozitat ligjore si me sipër e drejta e vlerësimit të nëpunësve civil është detyrim i përcaktuar ligjor të cilin duhet ta përmbushin të gjithë nëpunësit civil që kanë vartës gjatë ushtrimit të funksioneve publike.

Theksuar si me larte e në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## **KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS** **LËNDA, A.nr.262/2026**

**Ilire Mehmeti-Shaqiri**

Procesmbajtës

**Eshref Shabani**

Kryetar i Kolegjit

### **Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses, L.J;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Jashtë dhe Diasporës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.